



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1247 / prot. 2

Tiranë më 13.10.2017

REKOMANDIM

Nr. 43, datë 13.10.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Në zbatim të Urdhrit Nr.230, datë 15.09.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Rogat Security-1" sh.p.k Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Rogat Security-1" sh.p.k Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.230, datë 15.09.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "Rogat Security-1" shpk, është subjekt juridik me NIPT: K41930010Q, me objekt aktiviteti: "Shoqërimi i vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre dhe transportin e mallrave me vlerë me mjete të shoqërisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë etj..".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi e ka plotësuar detyrimin për "Njoftim" pranë Zyrës së Komisionerit por konstatohet se është i nevojshëm përditësimi i tij, për shkak se nuk janë deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë informacione në lidhje me kategoritë e të dhënave personale që përpunohen (si jeta personale, imazhe nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit CCTV), të

dhëna sensitive, gjendje penale, qëllimin e përpunimit, marrësin e të dhënave personale etj.

Konstatimi i pikës së parë përbën shkelje administrative të nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

2. Kontrolluesi disponon rregullore për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Rregullorja është pjesë e rregullores së përgjithshme për funksionimin e Sh.P.S.F "Rogat Security-I" shpk.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-surveimit, koha e ruajtjes së të dhënave në sistem është 27 ditë. Kontrolluesi nuk ka vendosur tabela informuese në hyrje të ambienteve në të cilin kontrolluesi ushtron aktivitetin.

Konstatimi i pikës së katërt, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", konkretisht përgjegjësinë dhe detyrimin që kontrolluesi ka në informimin e subjekteve të të dhënave personale. Kontrolluesi mbikëqyr lëvizjet e mjeteve motorrike të kompanisë nëpërmjet sistemit të gjeolokalizimit (GPS) dhe informon punëmarrësit nëpërmjet aktit të marrjes në dorëzim të këtyre mjeteve.

Gjithashtu kontrolluesi "Rogat Security-I" sh.p.k. Tiranë, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij ofron shërbimin tij kompanive të ndryshme. Në marrëdhëniet kontraktuale me ta, në shumicën e rasteve parashikohet konfidencialiteti në parim, pa përcaktuar saktësisht të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe aktit nënligjor të Komisionerit, Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012, "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".

Pavarësisht statusit të palëve kontraktuale, "kontrollues" apo "përpunues" detyrimet që burojnë nga ligji apo aktet nënligjore përcaktohen si më poshtë vijon (neni 20):

– "1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. **Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:**

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;

- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
 - d) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit,
 - e) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.
2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin”.

Në të tilla kushte, kontrolluesi është i detyruar të nënshkruaj marrëveshjet e konfidencialitetit me ofruesit e shërbimeve, sipas standardit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit. Gjithashtu, marrëveshjet e konfidencialitetit duhet të nënshkruhen dhe kur kontrolluesi gjendet në kushtet e përpunuesit dhe akseson të dhëna personale të kontrolluesve të tjerë, të cilëve i ofron shërbimin e tij.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Rogat Security-1” sh.p.k. Tiranë, të realizojë në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Rogat Security-1” sh.p.k. Tiranë, të vendos tabelat informuese në përputhje me Udhëzimin Nr.3 datë 05.03.2010 “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” në të gjitha ambjentet e vëzhguara me sistem video survejimi.
3. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Rogat Security-1” sh.p.k. Tiranë, të nënshkruajë marrëveshjet e konfidencialitetit me ofruesit e shërbimeve, sipas standardit të përcaktuar në Udhëzimin Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, edhe në rastet kur gjendet në kushtet e përpunuesit e akseson të dhëna personale të kontrolluesve të tjerë.

4. Kontrolluesi "Rogat Security-I" sh.p.k. Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13/10/2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi